

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Gani Avdiu dhe Burim Shala, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit B.K. nga fshati ... e Ulët, Komuna e Lipjanit, të cilin e përfaqëson i autorizuari A.K., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson F.M., Avokate Publike Komunale, për shkak të kompensimit të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës të përfaqësueses të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.189/15, i datës 27.10.2016, në seancën jo publike të mbajtur me datë 19.11.2018, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të autorizuarës të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan, C.nr.189/15, i datës 27.10.2016, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.189/15, të datës 27.10.2016, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e precizuar të paditësit, B.K. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, dhe e ka detyruar të paditurën Komuna e Lipjanit-Drejtoria e Arsimit, që paditësit të ia paguaj në emër të pagave të papaguara sipas kontratës së punës Nr.4-112-813/16, të datës 03.09.2012, për periudhën nga data 01.09.2012 e deri me datën 28.02.2013, si punëtor teknik në SHFMU "Ernes Koliqi" në fshatin Babush i Muhaxherëve: në emër të ardhurave personale (pagave) shumën prej 1.201.25.-€, në emër të kamatës për këtë periudhë për pagat e papaguara shumën prej 145.45 €, në emër të kontributit pensional shumën prej 129.60.-€, si dhe në emër të tatimit në pagë shumën prej 29.95.-€, e gjithsejtë shumën prej 1.346.70.- €.

Në pikën II të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që në emër të shpenzimeve gjyqësore, për padi shumën prej 104, për 2 përfaqësime të autorizuarit të paditësit shumën nga (135.20x2) gjithsejtë në emër të përfaqësimit shumën prej 270.-€, ndërsa në emër të kërkesëpadisë shumën prej 104.-€, në emër të ekspertizës financiare shumën prej 100.-€, në emër të taksës

gjqësore për padi dhe aktgjykim shumë prej 30.-€, gjithsejtë shumë prej 608.-€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, e autorizuar e të paditurës në afatin ligjor ka ushtruar ankesë, për shkak të shkeljes të dispozitave materiale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljeve esenciale, me propozim bërë Gjykatës së Apelit që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar dhe aktgjykim i atakuar të priset dhe lëndë t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa e përfaqësueses të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi B.K. nga fshati ... e Ulët, Komuna e Lipjanit ka ushtruar padi me datë 22.05.2015, kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të pagave, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës .

Gjykata e shkallës së parë në procedurën e provave me propozimin e palëve ndërgjyqëse administroj këto prova: kontratën e punës me Nr.4-112-813/166, të datës 01.9.2012, transaksioni i datës 30.04.2014, lëshuar nga ProCredit Bank, përgjigja në padi e datës 29.08.2016, ekspertiza financiare me numër 055/16, e datës 20.06.2016, specifikacioni i punës së kryer e lëshuar nga DKA e datës 09.03.2016, lista e pagave për muajin Mars 2013, si dhe precizimin i kërkesëpadisë, gjykata pas administrimit të provave të lartcekura e konform dispozitave të nenit 55.1 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykim i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk qëndron pretendimi ankimor i të autorizuarës së të paditurës se aktgjykim i ankimuar është i përfshirë në shkelje

thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së.

Aktgjykimi nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet dhe në lidhshmëri me këtë dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Përveç të cekurave arsyetimi i aktgjykimit përmban edhe referencën sa i përket të drejtës materiale me shpjegime se si është zbatuar e drejta materiale në raport me gjendjen faktike të cilën e ka provuar gjykata e shkallës së parë në këtë çështje kontestuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkelje lidhur me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që në rastin konkret faktet vendimtare të çështjes të paraqitura nga palët ndërgjyqësore gjykata e shkallës së parë i ka vërtetuar plotësisht me provat e administruara në shkresat e lëndës.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimit ankimore të përfaqësueses të paditurës se gjykata e shkallës së parë ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për arsye se borgji për periudhën kontestuese të cilën e paditura ja borxh paditësit për punën e kryer në shumën e caktuar, nuk ka pasur mundësi të ja paguaj për shkak të rrethanave buxhetore dhe me arsyetim se ka pasur mungesë të mjeteve financiare, kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara pasi që e paditura e ka pranuar faktin se paditësi ka lidhur kontratë mbi marrëdhënien e punës Nr.4-112-813/166, të datës 01.9.2012, me paditësin për periudhë të caktuar, ku paditësi tek e paditura ka punuar me orar të plotë 40 orë në javë për pagën bazë mujore në shumë prej 216.00 € e cila pagë bazë paditësit nuk i është paguar për periudhën nga data 01.09.2012 e deri me datën 28.02.2013, e kjo vërtetohet edhe nga Specifikacioni i punës të kryer nga na e paditësit të cilin e ka lëshuar e paditura me datë 09.03.2016, nga e cila rezulton se paditësi për periudhën e lartcekur për punën të cilën e ka kryer për të paditurën sipas kontratës së punës i njëjti nuk është kompensuar fare.

Gjykata e Apelit vlerëson se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike, e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë nga ka rrjedhë edhe themelësia e kërkesëpadisë.

Duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes rezulton se gjykata drejtë ka aplikuar të drejtën materiale duke ju referuar në arsyetim të aktgjykimit dispozitës së nenit 55 paragrafi 1, të Ligjit të Punës, nr.03/L-212 i cili përcakton së: "I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, aktin e Brendshëm të Punëdhënësit". Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Edhe vendimi mbi shpenzimet është në harmoni me dispozitat e LPK-së, ndërsa lartësia e shpenzimeve është në harmoni me vlerën e taksës gjyqësore dhe shpenzimeve tjera për përfaqësim.

Nga se u tha më lart u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.1025/17, me datë 19.11.2018

Kryetari i kolegjit
Ramë Hyseni

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt.19.11.2018, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 140.1 të LPK-së.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

Vërtetojnë:

Anëtarët e kolegjit

**Kryetari i kolegjit
Ramë Hyseni**

Gani Avdiu

1._____

Burim Shala

2._____